



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 39, datë 11.3.2016

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHURIN NR.70, DATË 7.5.2015,  
TË KRYEMINISTRIT, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS  
DHE TË ORGANIKËS SË MINISTRISË SË PUNËVE  
TË BRENDSHME", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 7, ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.70, datë 7.5.2015, të Kryeministrit, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në skemën 2, që përmendet në pikën 2, të urdhrit, ndarja II, "Zëvendësministër", të bëhet:

**"II. Zëvendësministër**  
Sekretar i zëvendësministrit

(3)  
3."

2. Pika 3 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të jetë, gjithsej, 177 veta."

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të punonjësve në detyrë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA